



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut

Dokument parlamentar

PROCESVERBAL

Datë 15.06.2015, ora 10:00

Drejton mbledhjen:

Fatmir Xhafaj – kryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

1. Miratimi i kalendarit 3-javor, 12 qershor – 02 korrik 2015.
2. Projektligji “Për miratimin e përjashtimeve nga taksat dhe parashikimeve për heqjen dorë nga imuniteti i kushtëzuar, sipas marrëveshjes së garancisë në lidhje me marrëveshjen e huas për financimin e zbatimit të projektit për ndërtimin e rrjeteve numerike (Dixhitale) DVB-T2 të transmetuesit publik (RTSH).

Marrin pjesë:

Fatmir Xhafaj, Oerd Bylykbashi, Bashkim Fino, Dashamir Peza, Pandeli Majko, Ulsi Manja, Vasilika Hysi, Vexhi Muçmataj, Anila Agalliu, Petrit Vasili, Silva Caka, Arben Ristani, Eduard Halimi, Gent Strazimiri, Mhill Fufi, Fatmir Mediu, Tahir Muhedini, Nard Ndoka, Xhemal Qefalia

Mungon:

Tom Doshi.

I ftuar:

Marius Borokoçi – specialist në Ministrinë e Financave.

Loreta Andoni – koordinatorë e Departamentit të Axiendës Europiane dhe TIK.

Brikena Jazxhi – specialiste në Ministrinë e Financave.

Vladimir Bisha – zëvendësdyrektor i Autoritetit Rrugor Shqiptar në Ministrinë e Transportit dhe Infrastrukturës.

HAPET MBLEDHJA

Fatmir Xhafaj – Mirëmëngjes!

Fillojmë mbledhjen e komisionit. Fillimisht kemi kalendarin, që ju është dërguar me email, por që është bërë një projekt në kushte normale, mbi bazën e kalendarit që është miratuar në seancë, por që nuk dimë sa do të zbatohet për shkak të faktit që jemi në situatën zgjedhore dhe nuk do të ketë mbledhje.

Biem dakord me kalendarin? Dakord.

Vazhdojmë me pikën tjetër të rendit të ditës, me projektligjin “Për miratimin e përjashtimeve nga taksat dhe parashikimeve për heqjen dorë nga imuniteti i kushtëzuar, sipas marrëveshjes së garancisë në lidhje me marrëveshjen e huas për financimin e zbatimit të projektit për ndërtimin e rrjeteve numerike (Dixhitale) DVB-T2 të transmetuesit publik (RTSH)”.

Nga Ministria e Financave kemi zotin Marius Borokoçi.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Urdhëro?

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Ta gëzoni! Gjithashtu, e pranishme është zonja Loreta Andoni, koordinatore e Departamentit.

Ju lutem, na bëni një paraqitje të projektit.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Në rregull.

Loreta Andoni – Meqenëse projektligji ka vetëm dy elemente financiare, prezantimin do ta bëjë përfaqësuesi i Ministrisë së Financave.

Fatmir Xhafaj – Në rregull, por ju lutem shkurtimisht, nëse keni ndonjë gjë të veçantë, sepse deputetët e kanë përpara projektligjin.

Marius Borokoçi – Pas negociatave të bëra me *Deutsche Bank* për projektin në fjalë, *Deutsche Bank* u kërkonte dy përjashtime, përjashtimin nga taksat dhe heqjen dorë nga imuniteti.

Pas konsultave që kemi bërë me Avokaturën e Shtetit e të tjerë, kemi rënë dakord që të hiqet dorë, domethënë të futet një pikë përjashtimore për heqjen dorë nga imuniteti, por duke përjashtuar tri pika, të cilat janë edhe në relacionin përkatës. Mund t’i përmend?

Fatmir Xhafaj – Po, po.

Marius Borokoçi – Përrjashtimi nga heqja dorë e imunitetit bëhet: “1. Për godinat e misionit aktual apo të ardhshme, siç përcaktohen në Konventën e Vjenës për marrëdhëniet diplomatike të nënshkruara në vitin 1961, godinat konsullore aktuale apo të ardhshme, siç përcaktohet në Konventën e Vjenës për marrëdhëniet konsullore të nënshkruara në vitin 1963 ose të tjera që përdoren nga misioni diplomatik i Shqipërisë, 2. Çdo pasuri të paluajtshme sipas parashikimeve të nenit 3, paragrafët 1 dhe 3 të ligjit shqiptar nr.8743 të datës 22.02.2001 “Për pasuritë e paluajtshme shtetërore”, i ndryshuar.

Pika 3: “Çdo fond monetar dhe/ose shuma që është maturuar dhe është shlyer në momentin e ekzekutimit për përmbushjen e detyrimeve të Republikës së Shqipërisë sipas së drejtës publike, traktateve ndërkombëtare, konventave dhe/ose marrëveshjeve të nënshkruara prej saj”. Këto ishin tri pikat përjashtimore, për të cilat Avokatura e Shtetit kërkoi që të hiqeshin në heqjen dorë të imunitetit.

Në marrëveshjen që u nënshkrua me *Deutsche Bank* në datën 11 qershor u pranuan këto tri pika që të përjashtohen, ashtu sikurse sugjeroi Avokatura e Shtetit. Ndërkohë, për sa i përket pjesës për heqjen dorë të taksave, me ligjin e ri të borxhit për subjektet private, Ministria e Financave ka autoritetin që të nënshkruajë garancitë, por në rastin konkret, meqenëse heqja dorë nga taksat dhe heqja e imunitetit kërkon që të ratifikohet me ligj, u futën këto dy pika për t’u ratifikuar me ligj dhe jo e gjithë marrëveshja e garancisë.

Faleminderit!

Fatmir Xhafaj – Faleminderit!

Ka pyetje? Po, zoti Fino.

Bashkim Fino – Faleminderit!

Kam dy çështje që dua të më japin përgjigje, megjithëse jam edhe relator, se në përgjithësi ne jemi komision për dhënie mendimi për këtë marrëveshje (komisioni përgjegjës është Komisioni i Medies), kjo është një kredi që duhet t’i marrim *Deutsche Bank*-ut për dixhitalizimin me sa kuptoj unë të radiotelevizionit shqiptar që duhet bërë sa më shpejt.

Këtu shtrohen dy çështje.

Neni 1 i projektligjit i referohet marrëveshjes së garancisë, e cila nga relacioni i paraqitur rezulton se nuk është nënshkruar nga shteti shqiptar. A nuk është i parakohshëm përjashtimi me ligj i taksës apo i heqjes dorë nga imuniteti kur ne nuk e kemi nënshkruar këtë marrëveshje me *Deutsche Bank*? Kjo është pyetja e parë, se ne nuk kemi kaluar ndonjëherë ndonjë ligj në parlament po nuk ka ardhur këtu marrëveshja e nënshkruar nga pala shqiptare. Në rastin konkret, marrëveshja nuk na është nënshkruar nga pala shqiptare. E pse ne duhet ta

kalojmë në parlament, t'i japim fletë të bardhë dhe t'u themi: "Po ju heqim nga taksat e nga të gjitha", ndërkohë që nuk është bërë një marrëveshje që të vijë këtu e nënshkruar? Pyetja e parë.

Pyetja e dytë, ndoshta kjo është teknike: në nenin 1 të projektligjit përdoret termi "taksat", ndërkohë që në marrëveshjen e garancisë përmenden fjalët "tatimet e mbajtura në burim". Kjo duhet rregulluar pak.

Vetëm këtë pikë kam unë që duhet ta sqaroj me veten time dhe pastaj nuk kam asnjë lloj problemi me projektligjin në fjalë.

Faleminderit!

Fatmir Xhafaj – Faleminderit!

Përfaqësuesit e qeverisë?

Marius Borokoçi – Faleminderit, zoti Fino!

Siç ju thamë, marrëveshja u nënshkrua në datën 11 qershor dhe mund t'jua vëmë në dispozicion.

Fatmir Xhafaj – Është nënshkruar marrëveshja?

Marius Borokoçi – Po, është nënshkruar në datën 11 qershor.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Nuk e kemi sjellë pasi ishte ditë e enjte dhe koha ishte shumë e limituar.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Punohet, por u nënshkrua në Gjermani dhe koha ishte shumë e limituar. Gjithsesi, mund t'jua vëmë në dispozicion.

Faleminderit!

Fatmir Xhafaj – Në rregull.

Faleminderit!

Ka tjetër gjë për këtë pikë? Nuk ka. Ka diskutime? Nuk ka.

Kush është dakord në parim? Kundër? Nuk ka. Abstenim? 1 votë abstenim.

Faleminderit!

Vazhdojmë me votimin nen për nen.

Neni 1. Kush është dakord? Kundër? Nuk ka. Abstenim?

Miratohet.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Ka abstenime?

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Për nenin 1?

(Ndërhyrje nga deputetët e opozitës pa mikrofon.)

Për të gjithë? Qeveria, kur keni qenë ju, e ka filluar këtë projekt, tani po mohoni veten?

Dakord, nuk ka problem.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Dakord.

Neni 2? Dakord.

Miratohet.

Kush është dakord në tërësi? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka. Miratohet.

Faleminderit!



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut

Dokument parlamentar

PROCESVERBAL

Datë 15.06.2015, ora 10:00

Drejton mbledhjen:

Fatmir Xhafaj – kryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

Projektligji “Për ratifikimin e marrëveshjes së huasë ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim për projektin “Mirëmbajtje dhe siguri rrugore bazuar në rezultate”.

Marrin pjesë:

Fatmir Xhafaj, Oerd Bylykbashi, Bashkim Fino, Dashamir Peza, Pandeli Majko, Ulsi Manja, Vasilika Hysi, Vexhi Muçmataj, Anila Agalliu, Petrit Vasili, Silva Caka, Arben Ristani, Eduard Halimi, Gent Strazimiri, Mhill Fufi, Fatmir Mediu, Tahir Muhedini, Nard Ndoka, Xhemal Qefalia

Mungon:

Tom Doshi.

Të ftuar:

Brikena Jazxhi – specialiste në Ministrinë e Financave.

Vladimir Bisha – zëvendësdirjtor i Autoritetit Rrugor Shqiptar në Ministrinë e Transportit dhe Infrastrukturës.

Fatmir Xhafaj – Vazhdojmë me projektligjin “Për ratifikimin e marrëveshjes së huasë ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim për projektin “Mirëmbajtje dhe siguri rrugore bazuar në rezultate”.

Nga Ministria e Financave kemi zonjën Brikena Jazxhi, kurse nga Autoriteti Rrugor Shqiptar, zotin Bisha.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

As titullarët tuaj nuk vijnë këtu, apo edhe ata janë në fushatë?

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Na bëni, ju lutem, një paraqitje të projektligjit.

Vladimir Bisha – Përshëndetje!

Jam zëvendësudrejtor i Autoritetit Rrugor Shqiptar.

Projektligji bën fjalë për mirëmbajtje dhe siguri rrugore. Ky është një projekt që do të bashkëfinancohet nga Banka Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim, pjesë e grupit të Bankës Botërore.

Bëhet fjalë për tre komponentë: të përmirësojë rrjetin e rrugëve kryesore dytësore të rrjetit primar, të përmirësojë sigurinë rrugore dhe të ofrojë asistencë në reformën sektoriale dhe institucionale.

Ky projekt do të përfshijë 1400 kilometra rrugë parësore, që do të shërbejë në mirëmbajtjen periodike rutinë për një periudhë pesëvjeçare dhe një koncept të ri mirëmbajtjeje, që është ofruar nga një studim i Bankës Botërore. Kjo parashikohet të fillojë në pjesën e dytë të këtij viti.

Anila Agalliu – Faleminderit, zoti kryetar!

Duke e parë këtë projektligj në aspektin ligjor, projektligji është në përputhje me Kushtetutën dhe në aspektin procedural, ka respektuar të gjitha kërkesat sipas Rregullores së Kuvendit. Prandaj, ftoj të gjithë anëtarët e komisionit që ta miratojnë këtë projektligj dhe ta çojmë për votim në seancë plenare.

Faleminderit!

Fatmir Xhafaj – Faleminderit, zonja Agalliu!

Ka diskutime? Nuk ka.

Kush është dakord në parim?

Faleminderit!

Neni 1. Dakord?

Anila Agalliu – Te neni 1, pas fjalës “bazuar në rezultate” të shtojmë fjalët “sipas tekstit bashkëlidhur këtij ligji”.

Fatmir Xhafaj – Në rregull.

Kush është dakord me nenin 1, me sugjerimin e bërë? Dakord.

Faleminderit!

Neni 2. Dakord?

Faleminderit!

Kush është dakord në tërësi? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Faleminderit!

Mbledhja mbyllet këtu.

MBLEDHJA MBYLLET